


NGJITËSIT E PLLAKAVE



DEKORAPID C2FT

Ngjyra	Paketimi	Konsumi
Gri	25 KG	3-5 KG

PËRSHKRIM

DekoRapid është një ngjitës pllakash me bazë çimento, i modifikuar me polimer dhe me mpiksje të shpejtë. Ofron një forcë ngjitëse të lartë si dhe rezistencë ndaj lagështisë. Klasifikohet si ngjitës e llojit C2 FT sipas standardit EN 12004.

FUSHA E APLIKIMIT

Dekorapid është i përshtatshëm për ngjitjen e pllakave të ndryshme në mure dhe dyshe, në ambiente të jashtme dhe të brendshme. Ideal në rastet kur kerkohet mbyllja e shpejtë e punimeve. I përshtatshëm për ngjitjen e pllakave të qeramikes në suporte me bazë çimento, gres-porcelanit, mermerit dhe pllakave me absorbim të ulët. Për ngjitjen në bazamente me një lëvizshmëri të caktuar të tilla si ballkone, tarraca, banjo, për dyshe dhe mure në ambiente të jashtme dhe të brendshme ku ka prani lagështie. Për dyshe me trafik të lartë si shkolla dhe spitale. I përshtatshëm për ngjitjen e pllakave për formate mesatare dhe të mëdha.

SPECIFIKIME

Ngjitës me bazë çimento, i përbërë nga rërë mermeri shumë cilësore me granulometri të seleksionuar, rezina sintetike dhe aditivë special të modifikuar. Teknologjia shumë e lartë në shpërndarjen granulometrike dhe përbërësit special i japin këtij produkti karakteristika të shkëlqyera në fleksibilitet dhe punueshmëri, ç'ka e bën këtë ngjitës ideal për ngjitjen e pllakave të mermerit, gurit natyror, granitit, mozaikëve, etj. (5-200 cm)

MËNYRA E PËRGATITJES SË PËRZIERJES

Përzieni 6.5-7 litra ujë të pastër me 25 kg DEKORAPID, përzieni masën e krijuar me një përzierës elektrik derisa të formohet një masë homogjene dhe pa kokërriza. Lëreni në qetësi për 5 minuta dhe më pas përziheni përsëri përpara përdorimit. Koha e punueshmërisë së përzierjes është 60 minuta, koha e korrigjimit 20 minuta në kushte normale temperaturash (23°C).

PËRGATITJA E SUPORTIT

Suportet me bazë çimento duhet të jenë të qëndrueshëm, rezistent dhe të rregullt, pa vajra dhe pa mbetje bojrash si dhe duhet të kenë arritur paraprakisht kohën e maturimit. Përafërsisht dyshemetë tradicionale me bazë çimento me kohë fortësimi normale duhet të kenë një kohë stazhionimi të paktën 28 ditë. Bazamentet me suva tradicionale duhet të thahen për të paktën 14 ditë. Disnivelet e mëdha ose çarjet e mëdha duhen të rregullohen paraprakisht. Të gjitha tipet e suporteve duhet të pastrohen paraprakisht para aplikimit të produktit në mënyrë mekanike. Përpara aplikimit të produktit, sipërfaqja e suportit duhet të spërkatet me ujë në mënyrë që produkti të krijojë një ngjitje sa më të mirë.





APLIKIMI

Fillimisht produkti rekomandohet të shtrohet me pjesën e drejtë të mallës për të pasur një shpërndarje sa më të njëtrajtshme dhe më pas me pjesën e dhëmbëzuar. Aplikimi bëhet me një mallë të përshtatshme në varësi të llojit të pllakës që shtrohet. Vendosja e pllakave bëhet duke ushtruar një presion të vogël mbi pllakë duke siguruar që pllaka të mbulohet në të gjithë sipërfaqjen me kollë. Koha e hapjes së produktit në kushte atmosferike normale është 35 minuta për temperatura 23°C. Kushtet atmosferike mund të ndikojnë në kohën e tharjes së produktit. Duhet pasur kujdes që kolla nuk duhet të formojë sipërfaqje filmi. Në të kundërt atëherë është e nevojshme që të kalohet dhe një herë malla mbi kollë. Produkti i përgatitur duhet të mbulohet me pllaka brenda 20 minutash me qëllim që të evitohet formimi i "cipës", d.m.th. përpara se shtresa e ngjitësit të fillojë të mpikset.

TË DHËNAT TEKNIKE

Pamja: Pluhur	Temperatura e aplikimit: +5°C deri në +35°C
Paketimi: Thes letre 25 kg në paleta 1350 kg	Koha e korigjimit: 35 min
Ngjyra: Gri	Mbushja e fugave në mure: Pas 3 orësh
Konsumi: 3-5 kg/m ²	Mbushja e fugave në dyshe: Pas 4 orësh
Magazinimi: Të ruhet në vende të thata mbi paleta druri	Forca ngjitëse pas 28 ditësh: ≥1 N/mm ²
Koha e Magazinimit: 12 muaj nga data e prodhimit	FN pas zhytjes në ujë: ≥0.5 N/mm ²
Masa vëllimore: 1.6-1.7 gr/cm ³	FN pas reaksionit nga ngrohja: ≥1 N/mm ²
Reaksioni ndaj zjarrit: Klasa A1	FN pas cikleve ngrirje-shkrirje: ≥1 N/mm ²
Ujë për përzierje: 6.5-7 litra ujë për 25 kg	Rrëshkitshmëria: ≤0,5 mm
pH i përzierjes: 13	



Kujdes! Si temperaturat e ulta dhe temperaturat e larta mund të ndryshojnë karakteristikat e punimit të produktit (ngadalsim ose përshtetshmëri në tharje të produktit). Për formate pllakash shumë të mëdha, aplikoni shtrim të dyfishtë të kollës në pllakë dhe bazament. Mbroni bazamentin për të paktën 24 orë pas aplikimit të ngjitësit, nga shirat e rrëmbyer si dhe nga ngricat dhe rrezet e forta të diellit.